



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 810 Prot

Tiranë, më 12.02 2015

URDHËR

Nr. 72 datë 11.02. 2015

PËR

**PROCEDURAT E INSPEKTIMIT TË SHËRBIMIT TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT,
SPITALEVE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE QË PËRDORIN GJAK DHE KOMPONENTË
TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 25 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rekomandimeve të Komitetit Kombëtar të Gjakut,

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullore “ Për procedurat e inspektimit të shërbimit të transfuzionit të gjakut, spitaleve publike dhe jo publike që përdorin gjak dhe komponentë të tij”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror për zbatimin të këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 84, datë 07.03.2008 Për miratimin e rregullore “Për procedurat e inspektimit të shërbimit të transfuzionit të gjakut dhe strukturave klinike që përdorin gjakun” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

